

VENDIM
Nr. 142, datë 8.3.2023

**PËR NJË SHITESË FONDI NGA FONDI REZERVË NË BUXHETIN E
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE PËR FINANCIMIN E
INFRASTRUKTURËS MBËSHTETËSE, NË KUADËR TË ORGANIZIMIT NË
TIRANË TË SAMITIT TË PROCESIT TË BERLINIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e vitit 2023, në programin “Shërbime qeveritare”, t’i shtohet fondi prej 61 000 000 (gjashtëdhjetë e një milionë) lekësh, për financimin e infrastrukturës mbështetëse, në kuadër të organizimit në Tiranë të Samitit të Procesit të Berlinit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.

3. Fondi prej 61 000 000 (gjashtëdhjetë e një milionë) lekësh, me kërkesë të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, alokohet me destinacion projektin zbatues, përfshirë rikonstruksionet e nevojshme për krijimin e infrastrukturës mbështetëse, të paraqitur nga kjo drejtori pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama